



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 104/5 Prot.

Tiranë, më 27.04.2017

V E N D I M

Nr.107, datë 27/04/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit nr.158, datë 13.12.2016 dhe ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të emërimeve nga institucioni i Drejtorisë së Bujqësisë Kukës, prej datës 22.09.2016 e në vazhdim"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenin 34 e vijues të Rregullores, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr.158, datë 13.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Bujqësisë Kukës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë", në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Kukës,

VËREJ SE:

Me Vendimin Nr.138, datë 30.12.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil. Bazuar në këtë vendim ka vijuar mbikëqyrja edhe në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Kukës. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr.158, datë 13.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Bujqësisë Kukës dhe paralajmërimin

e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Bujqësisë Kukës, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, si dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, duhet të marrin masa dhe të tregojnë kujdes, që për çdo procedurë që ka lidhje me menaxhimin e shërbimit civil, të bëjnë administrimin e tyre edhe në mënyrë shkresore sipas kërkesave të ligjit dhe me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil nga nëpunësit përgjegjës, në përputhje me hierarkinë administrative, ashtu dhe nga institucionet e ngarkuara nga ligji për mbikëqyrjen e shërbimit civil.

Në këtë këndvështrim, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të finalizojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, duke u kujdesur që të merret mendimi i Departamentit të Administratës Publike dhe më tej të depozitohet ato në arkivin e institucionit, si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike.

3. Njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Bujqësisë Kukës, në lidhje me procesin e planifikimit vjetor të pranimit në shërbimin civil, duhet të mbajë parasysh rastet e mbushjes së moshës së pensionit, parashikimin e vendeve të reja në shërbimin civil dhe të marrë masa për realizimin e tij në përputhje me afatet dhe procedurat respektive, të parashikuara në mënyrë të detajuar në pikën 5, 7 dhe 8, të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.
4. Për të rregulluar ligjshmërinë e procesit të ristrukturimit në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Kukës, njësia përgjegjëse (DAP), në kuptim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duhet të marrë masa që për punonjësit ***** dhe ***** , të cilët janë transferuar në pozicione jashtë shërbimit civil, të ndryshojë pjesërisht aktin nr. 3126/1, datë 24.06.2015, “Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Kukës”, në pikën 2 dhe 3, duke ndjekur hapat si më poshtë:

- Të nxjerrë aktet individuale të lirimit nga shërbimi civil, për punonjësit ***** dhe ***** , për shkak të përfundimit të marrëdhënies së punës, në kuadër të ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Kukës.
- Në kuptim të nenit 50, pika 8, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, t’u njohë punonjësve ***** dhe ***** , të drejtën që brenda periudhës 2-vjeçare, nga data e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurën e lëvizjes

paralele apo të ngritjes në detyrë, në pozicione pune të shërbimit civil dhe të njoftohen punonjësit për këto akte.

5. *Njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Bujqësisë Kukës dhe personat përgjegjës, të ngarkuar nga ligji me detyrën e vlerësimit të rezultateve në punë, duhet të mbajnë parasysht orientimet e Komisionerit, të cilat janë të materializuara në raportin e mbikëqyrjes, më qëllim kryerjen e vlerësimit të rezultateve në punë në mënyrë sa më objektive, duke e lidhur procesin me realizimin e detyrave konkrete të secilit nëpunës.*
6. *Njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Bujqësisë Kukës, në respektim të nenit 61, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për nëpunësit ***** dhe ***** , ndaj të cilëve është marrë masa disiplinore “Vërejtje”, duhet të ndër marrë hapat si më poshtë:*
 - *Të vendosë shuarjen e masës disiplinore “Vërejtje”, të marrë ndaj nëpunësës ***** , me urdhrin nr. 37, datë 15.07.2014;*
 - *Të vendosë shuarjen e masës disiplinore “Vërejtje”, të marrë ndaj nëpunësit ***** , me Urdhrin nr. 38, datë 15.07.2014;*
 - *Masat e mësipërme disiplinore të fshihen nga dosjet e personelit dhe nga regjistri përkatës.*
7. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues nr. 158, datë 13.12.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin Drejtoria e Bujqësisë Kukës, prej datës 22.09.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, me vendimin nr.26, datë 10.02.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 158, datë 13.12.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga institucioni, Drejtoria e Bujqësisë Kukës, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 22.09.2016 e në vazhdim”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 158, datë 13.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Bujqësisë Kukës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Altin Shumeli, Drejtor i Mbikëqyrjes, Ledina Zhupa, Inspektor në Drejtorinë e Mbikëqyrjes dhe Ilirjan Osmanlliu, Specialist në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 24.03.2017, u paraqitën pranë institucionit, Drejtoria e Bujqësisë Kukës.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Kukës, dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 104/2 prot., datë 10.02.2017, *“Njoftim për fillimin e verifikimit”*.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore, si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqërues që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e datës 24.03.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi i kontaktit i institucionit, Drejtoria e Bujqësisë Kukës, specialisti për burimet njerëzore.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Në zbatim të pikës 2 të vendimit, Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit ka hartuar përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil. Me shkresën nr.557, datë 27.12.2016, *“Kërkohet mendim për përshkrimet e pozicioneve të punës në Drejtorinë e Bujqësisë Kukës”*, i është kërkuar Departamentit të Administratës Publike që të konfirmojë nëse përshkrimet e punës janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç përcaktohet në pikën 19, të Vendimit Nr.142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*. Në momentin e verifikimit, nga ana e Departamentit të Administratës Publike nuk është kthyer përgjigje në lidhje me shkresën e sipërcituar.
- Në zbatim të pikës 3 të vendimit, njësia përgjegjëse bazuar në nenin 18 të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Vendimin nr.108, datë 26.02.2014, *“Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”*, me shkresën nr.558, datë 28.12.2016, ka bërë një informacion mbi planin e nevojave për rekrutim për vitin 2017, si dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për secilin nga vendet e lira.
- Me shkresën nr.134 Prot., datë 01.03.2017, Drejtoria e Bujqësisë Kukës, në zbatim të pikës 4 të rekomandimit të vendimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike interpretim në lidhje me situatën ligjore të punësimit për punonjësit ***** dhe *****, të cilët për shkak të ristrukturimit të institucionit, Drejtoria e Bujqësisë Kukës, me aktin nr.3126/1, datë 24.06.2015, i ka transferuar në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.

Ndërkohë, në momentin e verifikimit, rezulton se, ka ndryshuar regjimi juridik i marrëdhënies së punës për nëpunësit e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, duke i përfshirë ata përsëri në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

Në rastin konkret, ky ndryshim, është pasqyruar në Vendimin nr. 877, datë 14.12.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 719, datë*

31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, ku përcaktohet:

- Pika 9: “Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AZHBR-së rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të AZHBR-së, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës”.
- Pika 17: “Për nëpunësit aktualë të AZHBR-së zbatohen dispozitat e nenit 67, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar”.

Për të vënë në zbatim këto ndryshime, sipas pikës 5, të vendimit të sipërcituar, është ngarkuar Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si dhe Departamenti i Administratës Publike.

Në këtë rast, duhet të mbahet parasysh nga njësia përgjegjëse fakti, që këta nëpunës, e gëzojnë statusin e nëpunësit civil që në momentin e deklarimit të tyre pranë Drejtorisë së Bujqësisë Kukës, sipas interpretimit që është bërë më lart nga Komisioneri. Ky fakt vlen për të përcaktuar kohëzgjatjen e punësimit të këtyre punonjësve në pozicionin e punës ku ata kryejnë detyrën, në momentin e deklarimit të statusit të punësimit pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.

- Në zbatim të rekomandimit të pikës 5 të vendimit paralajmërues të Komisionerit, njësia e burimeve njerëzore dhe personat përgjegjës të ngarkuar nga ligji me detyrën e vlerësimit të rezultateve në punë, në përputhje me rekomandimin e Komisionerit kanë bërë vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën Korrik-Dhjetor 2016.
- Njësia e burimeve njerëzore e Drejtorisë së Bujqësisë, në zbatim të rekomandimit të pikës 6 të vendimit të Komisionerit dhe bazuar në nenin 61, pika 1, gërma “a” të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me aktin administrativ nr.7, datë 30.12.2016, ka vendosur shuarjen e masës disiplinore “Vërejtje”, të marrë ndaj nëpunësit Fatmir Rexha dhe me aktin administrativ nr.8, datë 30.12.2016 ka vendosur shuarjen e masës disiplinore “Vërejtje”, të marrë ndaj nëpunëses *****, duke proceduar edhe me fshirjen e tyre nga dosjet e personelit dhe regjistri përkatës.

Për sa u përket më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr. 158 datë 13.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Drejtorinë e Bujqësisë Kukës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, të Komisionerit, rezultoi se nga ana e njësive të burimeve njerëzore të institucionit të Drejtorisë së Bujqësisë Kukës janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

Në përfundim të procesit të verifikimit në subjekt, lidhur me ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Kukës, prej datës 22.09.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, nuk rezultoi asnjë akt administrativ emërimi i nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për pozicione pune të shërbimit civil.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe 34 të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Drejtorisë së Bujqësisë Kukës, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 158, datë 13.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Drejtorinë e Bujqësisë Kukës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.
2. Verifikimin e mëtjshëm të pikave 2 dhe 4 të dispozitivit të Vendimit nr. 158, datë 13.12.2016, për të cilat kërkohet reagimi i Njesisë Përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.
3. Konstatimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative, të kryera gjatë procesit të emërimeve nga institucioni i Drejtorisë së Bujqësisë Kukës, prej datës 22.09.2016 e në vazhdim.
4. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Drejtorisë së Bujqësisë Kukës, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA